



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

URDHËR

Nr. 213, datë 22.07.2016

**“Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.122, Datë 10.04.2013 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, gërma “gj” e ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

Në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori” bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në pjesën hyrëse të Rregullores pas shprehjes “Direktivat 2002/58/EC dhe 95/46/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian” shtohet shprehja, “Direktiva 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit”.

**Neni 2**

Në nenin 4, gërmat “d” dhe “f” ndryshohen si më poshtë :

“d) “Sistem arkivimi” është çdo grup i strukturuar ose i pastrukturuar i të dhënave personale, të cilat janë të aksesueshme në bazë të kriterëve specifike, të centralizuara, të decentralizuara ose të shpërndara në një bazë, funksionale ose gjeografike;

“f) “Marrës” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër të cilit i janë dhënë të dhënat e një palë të tretë.”.

### Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 5

#### **Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale**

1. Përpunimi i të dhënave personale duhet:
  - a) Të respektojë parimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;
  - b) Të garantojë se të dhënat personale mblidhen dhe përpunohen vetëm për qëllim të veprimtarive të parandalimit, hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së autorëve të tyre, në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë;
  - c) Të respektojë parimin e proporcionalitetit, në mënyrë që të dhënat që do të përpunohen të jenë në atë masë sa nevojitet për të përmbushur qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
  - d) Të garantojë cilësinë dhe saktësinë e të dhënave dhe t’i përditësojë ato për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
  - e) Të sigurojë që të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për aq kohë, sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar dhe jo më tepër;
  - f) Të kryhet nga përpunuesi duke respektuar detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;
  - g) Të sigurojë parimin e transparencës duke garantuar të drejtën e subjektit të të dhënave për të marrë informacion në lidhje me qëllimin e përpunimit, të drejtën për të patur akses, të drejtën për të korrigjuar, bllokuar dhe fshirë këto të dhëna, në përputhje me aktet ndërkombëtare, ligjet e aktet nënligjore në fuqi;
  - h) Të garantojë sigurinë e të dhënave në përputhje me këtë rregullore.”.

### Neni 4

Në nenin 6, gërmat “c” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

- “c) Autorizohet nga kontrolluesi për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe/ose parandalimin e zbulimit e veprave penale, nën masa të përshtatshme mbrojtëse duke respektuar parimet e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje;
- d) Të dhënat përpunohen për qëllime statistikore, nën masa të përshtatshme mbrojtëse, kur nuk ka asnjë rrezik për shkelje të privatësisë së subjekteve.”.

### Neni 5

Neni 7, ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 7**  
**Transferimi ndërkombëtar i të dhënave**

1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës të vitit 1981 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, ligjin nr.9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe nëpërmjet marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të miratuara me ligj dhe akte nënligjore në fuqi.
2. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk gëzon statusin e vendit që ofron nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes, mund të bëhet nëse:
  - a) Autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga republika e shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;
  - b) Subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferimin ndërkombëtar të tyre;
  - c) Është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;
  - d) Është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;
  - e) Është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.
3. Shkëmbimi i të dhënave personale me institucione ndërkombëtare konsiderohet transferim ndërkombëtar.”.

**Neni 6**

Neni 8, i rregullores ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 8**  
**Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale**

1. Kontrolluesi i garanton subjektit të cilit i janë përpunuar të dhënat, këto të drejta:
  - a) Të drejtën për akses, që përfshin, njohjen e subjektit me qëllimin e mbledhjes së të dhënave, kategorinë e të dhënave që janë mbledhur dhe/ose do të mblidhen, kategorinë e subjekteve që do t’i zbulohen këto të dhëna;
  - b) Të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen;
  - c) Të drejtën për t’u informuar për kontaktet e kontrolluesit dhe oficerit të të dhënave personale;
2. Çdo person, të dhënat e të cilit janë përpunuar ose po përpunohen nga organi i prokurorisë, ka të drejtë që të njihet me to, duke ju drejtuar kontrolluesit vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kërkesa bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar identitetin e kërkuarit.
3. Aksesit në të dhënat personale mund të refuzohet në rastet kur njohja me këto të dhëna:

- a) Pengon ose paragjykon hetimin dhe ndjekjen penale;
  - b) Cënon sigurinë kombëtare;
  - c) Cënon sigurinë publike dhe / ose rendin publik;
  - d) Pengon parandalimin e krimit;
  - e) Cënon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.
4. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave. Në rast të refuzimit të aksesit sipas paragrafit 3 të këtij neni, njofton subjektin e të dhënave se janë kryer kontrole të përgjithshme por pa dhënë informacion tjetër.
  5. Në rastet kur subjekti i të dhënave ka kundërshtuar të dhënat e tij personale, prokurori kufizon përdorimin e tyre deri në verifikimin e pretendimeve të subjektit. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave për bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kundërshtuara prej tij. Kur kontrolluesi nuk bën bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave i njofton subjektin e të dhënave të drejtën për t'u ankuar te Komisioneri.
  6. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë. Vendimi i Komisionerit ose gjykatës është i detyrueshëm për zbatim.”

#### Neni 7

Neni 25, ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 25

#### **Mbikëqyrja dhe kontrolli i masave dhe procedurave mbrojtëse**

1. Mbikëqyrja dhe kontrolli i implementimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, për respektimin e normave të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale ose të paautorizuar, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe përhapjes së paautorizuar të tyre realizohet nga Zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Oficeri i mbrojtjes së të dhënave personale që ushtron funksionet pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, monitorojnë dhe ushtrajnë çdo vit kontroll në të gjithë sistemin e prokurorisë për zbatimin e detyrimeve të kësaj rregulloreje. Në përfundim të kontrollit, hartohet një raport me vërejtje dhe rekomandime.
3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi njihen me përfundimet dhe rekomandimet e grupit të kontrollit, japin udhëzimet e nevojshme për përpunuesit.”.

#### Neni 8

Neni 27, shfuqizohet.

**Neni 9**

Aneksi Nr.1 "Deklaratë konfidencialiteti" ndryshohet sipas formatit bashkëlidhur.

**Neni 10**

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**



**DEKLARATË KONFIDENCIALITETI**

Unë \_\_\_\_\_ si punonjës i Prokurorisë \_\_\_\_\_, kam dijeni të plotë që për shkak të detyrës do të kem akses në informacione/arkiva të cilat janë të konsideruara si konfidenciale.

Unë pranoj me përgjegjësinë time të plotë të respektoj dhe ruaj konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit në lidhje me informacionet/arkivat në të cilat kam akses duke respektuar palët e treta, të mos kopjoj asnjë të dhënë apo informacion pa leje të shkruar të titullarit të Prokurorisë, të mos nxjerr përmbajtjen e këtyre të dhënave personave të tjerë, si dhe të ndjek procedurat e punës në mënyrë të tillë që të mbroj privatësinë dhe të veproj në mënyrë profesionale, në përputhje me rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në prokurori” dhe “Marrëveshjen e Konfidencialitetit dhe Politikën e Sigurisë”.

Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me informacionet konfidenciale apo në rast të mosruajtjes së privatësisë, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarte të larta profesionale në zyrë dhe në Prokurorinë e \_\_\_\_\_.

\_\_\_\_\_  
**Nënshkrimi i të punësuarit**

\_\_\_\_\_  
**Nënshkrimi i eprorit**

Data \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_